



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 855, datë 10.12.2014

PËR

DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "D", "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida", shtohen individët e renditur në shkronjën "a", të listës, "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të

Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës Al-Qaida.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I PUNËVE
TË JASHTME

DITMIR BUSHATI



AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-
së”)

D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë
me organizatën Al-Qaida”;

1. ANSAR AL CHARIA DERNA
2. ANSAR AL CHARIA BENGHAZI

Shënim: Gjeneralitet e tjera për personat emrat e të cilave janë radhitur më
sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të
Parave.